



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KESHILLI I LARTË GJYQESOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2024

**VENDIM**

**Nr.700, datë 03.12.2024**

**PËR KUALIFIKIMIN E KANDIDATES ZNJ. {...} PËR T'U KOMANDUAR NË  
POZICIONIN “INSPEKTOR” NË ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË  
DREJTËSISË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 03.12.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për kualifikimin e kandidates znj. {...} për t’u komanduar në pozicionin “inspektor” në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, përgatitur nga relatori z. Klodian Kurushi, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së mëtejshme të komandimit “Inspektor” në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 284 datë 29.05.2024,

**VËREN**

**I. HYRJE**

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në shkronjën “ë”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 61, në shkronjën “d” të nenit 86, në shkronjë “b”, pika 1, të nenit 97, në pika 1 dhe 5 të nenit 209 dhe në nenin 211, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenet 53, 54, 55, 57 dhe 58, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me vendimin nr. vendimin nr.284, datë 29.05.2024 ka vendosur: “Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për tre pozicione: “Inspektor”.

2. Në vijim të vendimit sa më sipër për shpalljen e kërkesës, afati i paraqitjes së kërkesave për komandim ishte data 12.06.2024. Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është paraqitur vetëm 1 (një) kërkesë.

3. Me shkresën nr. 3175, datë 11.06.2024, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është protokolluar kërkesa e gjyqtarës {...}, e cila ushtron funksionin e gjyqtarës në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Znj. {...} ka shfaqur vullnetin për t'u komanduar në *Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë* për pozicionin "Inspektor".

3.1 Lidhur me dokumentet të cilat duhet të paraqesë në momentin e aplikimit kandidati sipas shkronjave "a", "b", "c", "ç", "d" dhe "dh", të pikës 4 të vendimit nr.284, datë 29.05.2024, rezultoi se znj. {...} ka paraqitur dokumentacionet si vijon:

- Kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për komandimin në pozicionin e inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë që mban datën 10.06.2024;
- Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit;
- Fotokopje të kartës së identitetit;
- Vetëdeklarim për mospasjen masë disiplinore në fuqi, që mban datën 10.06.2024;
- Vetëdeklarim për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të shkronjës "dh", pika 5, të nenit 209, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, që mban datën 10.06.2024;
- Vërtetim/Dëshmi nga Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore) për mosqenien i dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që mban datën 05.06.2024.

4. Në vendimin nr. 284, datë 29.05.2024 të Këshillit, konkretisht në Kreun II të tij, është përcaktuar edhe procedura që do të ndiqet nga Këshilli : *"Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, do të vlerësojë plotësimin e kushteve të komandimit nga kandidatët që do të aplikojnë. Ky vlerësim do bëhet brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të aplikimit. Komisioni përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat, i cili shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre. Opinionet e miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare të tij. Këshilli mund të vendos përjashtimin nga komandimi të kandidatit kur komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai ushtron funksionin ose kur verifikohet që kandidati nuk plotëson ndonjë prej kushteve të tjera të komandimit."*

- Sipas parashikimit të bërë **në pikën 13 të Kreut II**, Këshilli i Lartë Gjyqësor, i përcjell menjëherë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë aplikimet e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për komandimin në pozicionin "Inspektor".

- **Në pikën 15 të këtij Kreu**, parashikohet se: "Brenda dy javëve nga marrja e kërkesës, Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendos për komandimin, në pozicionin respektiv të kandidatit të përzgjedhur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë."

## II. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

5. Në respektim të procedurës që ndiqet sipas vendimit nr. 284, datë 29.05.2024 të Këshillit në fazën e parë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës verifikon plotësimin nga kandidatët të kushteve dhe kritereve për t'u komanduar në pozicionin "Inspektor".

5.1 Pika 5 e nenit 209 të Ligjit Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” parashikon se kandidatët për inspektorë, të cilët vijnë nga radhët e magistratëve/gjyqtarëve duhet të plotësojnë kushtet për të qenë anëtarë gjyqtarë në Gjykatën e Lartë. Kjo normë parashikon më tej se gjyqtarët e komanduar si inspektor, nuk duhet të jenë kryetar gjykate, apo dhe as anëtarët të organeve drejtuese të grupeve të interesit si shoqata apo sindikata magistratësh etj.

5.2 Kjo dispozitë kërkon më tej që gjyqtari kandidat për inspektor të jetë vlerësuar të paktën “shumë mirë” në dy vlerësimet e fundit të performancës etike dhe profesionale, të mos kenë masë disiplinore në fuqi, të mos jenë dënuar penalisht më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe të mos kenë asnjë anëtar të familjes si subjekt i veprimit të ligjit për deklarimin e pasurive të nëpunësve publik dhe të mos ketë të afërm të shkallës së parë që punon si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Nga këto parashikime ligjore del si konkluzion se, komandimi i gjyqtarëve si inspektor pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është i mundur vetëm për ata që ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme dhe kur japin pëlqimin e tyre.

5.2.1 Pavarësisht parashikimeve të posaçme në këtë ligj apo në ligje të tjera mbi procedurën e komandimit të magistratëve si inspektor, dispozita bazë dhe kuadër e realizimit të procedurës së çdo komandimi është neni 54 të Ligjit për Statusin. Veç zbatimit të kësaj procedure të përgjithshme, pika 2 e nenit 55 të Ligjit për Statusin parashikon se Këshilli i Lartë Gjyqësor, për kandidatët gjyqtarë, për inspektor pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryen procedurën e verifikimit të kandidatëve sipas parashikimeve të pikës 2 deri në pikën 7 të nenit 32 të Ligjit për Statusin.

5.2.2 Dispozita për këtë verifikim i referohet nenit 32, që parashikon procedurën e verifikimit të figurës së kandidatit për magistrat. Ky referim ligjor do të thotë se, Këshilli është i detyruar që përveç opinionit të kryejë edhe procedurën e verifikimit të pasurisë dhe pastërtisë së figurës konkretisht nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit. Pika 3 e nenit 55 të Ligjit për Statusin parashikon se gjyqtari, i cili komandohet si inspektor, konsiderohet magistrat i ngritur në detyrë në Gjykatën e Lartë. Ky parashikim është bërë, duke pasur parasysh edhe faktin se vetë ligji kërkon si kriter për realizimin e komandimit të magistratëve/gjyqtar si inspektorë plotësimin e kushteve të emërimit të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë. Nga ana tjetër ky parashikim ligjor ka dashur të rrisë interesin e magistratëve gjyqtarë për të kërkuar komandimin si inspektor dhe ndër të tjera edhe nëpërmjet kësaj mënyrë është synuar që të garantohet gjithnjë kushti ligjor që vendos pika 1 e nenit 209 të Ligjit Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, që jo më pak se gjysma e inspektorëve nga numri i parashikuar në organikën e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të jenë magistratë të komanduar.

### **III. NË LIDHJE ME KUSHTET E VEÇANTA TË KOMANDIMIT**

6. Kushtet e veçanta të komandimit përcaktohen në nenin 55, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Po ashtu ato janë përcaktuar në pikën 8 dhe 9, Kreu II të Vendimit të Këshillit nr. 284, datë 29.05.2024. Konkretisht, në këtë pikë të këtij vendimi përcaktohet se: “Kushtet e veçanta komandimit janë: a) *Kandidati duhet të plotësojë kushtet për emërim si magistrat në Gjykatën e Lartë, si më poshtë: i) të ketë ushtruar*

*funksionin si magjistrat jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar; ii) të kalojë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”;*

*b) në kohën e kandidimit, të mos jetë kryetar i një gjykate ose anëtar i organeve drejtuese të grupeve të interesit, të tilla si shoqata ose sindikata magjistratësh etj.;*

*c) të jetë vlerësuar të paktën “shumë mirë” në dy vlerësimet e fundit të performancës etike dhe profesionale;*

*ç) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;*

*d) të mos jetë i dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;*

*dh) në kohën e kandidimit, të mos ketë asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të Ligjit “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, ose të afërm të shkallës së parë, që punon si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*

6.1 Në vështrim të nenit 55, pika 1, të Ligjit për “Statusin” është parashikuar se ato magjistratë, që plotësojnë kriteret për t’u emëruar si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, mundet të komandohen në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në këtë kuadër, kushtet për të qenë gjyqtar magjistrat në Gjykatën e Lartë parashikohen fillimisht në pikën 3 të nenit 136 të Kushtetutës, ku kërkohet që magjistrati të ketë jo më pak se 13 vjet përvojë në ushtrimin e detyrës, ndërkohë që ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” në nenin 47 ka parashikuar kushtet dhe kriteret ligjore për t’u caktuar si gjyqtar në Gjykatën e Lartë. Në pikën 5 të këtij neni është parashikuar se, gjyqtari mundet të ngrihet në detyrë si gjyqtar pranë Gjykatës së Lartë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar.

6.2 Nga aktet e administruara rezulton se znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 06.07.2000, ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2003 dhe ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master në të drejtat e njeriut, Suedi, në vitin 2008 si dhe ka përfunduar studimet në Master ndërkombëtar në të drejtën evropiane, në Holandë, në vitin 2018. Me Vendim nr. 132/1, datë 21.10.2002 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohet provizorisht gjyqtare dhe caktohet për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekret nr. 3984, datë 21.10.2003 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare ushtarake në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe aktualisht ushtron funksionin në mënyrë të përhershëm.

6.3 Lidhur me kushtet e komandimit sipas shkronjës “a/ii”, në pikën 8, Kreu II të Vendimit të Këshillit nr.284, datë 29.05.2024,; a) *Kandidati duhet të plotësojë kushtet për emërim si magjistrat në Gjykatën e Lartë, si më poshtë: ii) të kalojë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për*

*procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”.*

7. Vijimi i procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore u përgatit nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës bazuar në Seksionit B, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, të ndryshuar, si dhe pikës 8, të Vendimit nr.284 datë 29.05.2024.

8. Më datë 13.06.2024, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidates iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit. Brenda afatit pesëditor, kandidatja depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

9. Në vijim të procedurës së verifikimit, më datë 13.06.2024, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidaten për Inspektor në ILD, znj. {...}.

#### **10. Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i “përvojës profesionale minimale”.**

11. “Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 8, të Vendimit të Këshillit nr.284 datë 29.05.2024, është parashikuar si kusht kandidimi në nenin 136, pika 3 (fjalë e parë), të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se: “Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me *të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit*”. Ndërkohë, “përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë parashikohet edhe në nenin neni 47, pika 5, të Ligjit për Statusin. Sipas kësaj dispozite, ky kriter kandidimi përbëhet në vetvete nga dy të tillë, ai për “përvojën e përgjithshme profesionale minimale” dhe ai për “përvojën specifike profesionale minimale”. Konkretisht në këtë dispozitë të ligjit përcaktohet se: “Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë Gjykatës së Lartë ..., nëse ka ushtruar funksionin *jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar*”.

12. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për Inspektor në ILD, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr.284 datë 29.05.2024, ka mbi trembëdhjetë vjet përvojë të përgjithshme profesionale, si gjyqtare në gjykatën e shkallës së parë dhe si gjyqtare e komanduar, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës profesionale minimale”.

#### **13. Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i “pasurisë dhe figurës”**

14. Neni 48, pika 7 dhe pika 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin), përcakton se: “7. *Këshilli verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji.* 8. *Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës ..., pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”.*

15. Sa sipër, kandidatja për Inspektor në ILD, do të duhet në çdo rast të kalojë me sukses verifikimin e pasurisë dhe të figurës. Megjithatë, në rastin e kandidatja që i është nënshtruar dhe ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, verifikimi për të i pasurisë dhe figurës sipas pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, do të shtrihet për periudhën pas datës që ka marrë formë të prerë vendimi i dhënë nga organet e rivlerësimit kalimtar.

16. Rezulton se kandidatja, znj. {...} i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, ndërsa është konfirmuar në detyrë me vendim përfundimtar, pikërisht me Vendimin nr. 19, datë 14.05.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit rezulton të ketë marrë formë të prerë më datë 29.06.2018, pasi nuk u ankimua. Ky vendim është publikuar në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe mban datën 02.07.2018. Për rrjedhojë, verifikimi i pasurisë dhe figurës për këtë kandidate u shtri për periudhën 11.02.2022 deri më 11.07.2024.

#### **A. Për kriterin e pasurisë**

17. Për kandidaten {...} u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikat 7 dhe 8, të nenit 48 në lidhje me pikat 2 deri në 7, të nenit 32<sup>1</sup>, të Ligjit për Statusin, për periudhën pas dhënies së vendimit nga organet e rivlerësimit kalimtar.

---

<sup>1</sup> “2. ..., për secilin kandidat ..., Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë. 3. Çdo institucion publik, subjekt fizik ose juridik, duhet të përmbushë kërkesat e Këshillave për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda afatit ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga Këshillat në kërkesën e tyre. 4. Në çdo rast, kandidati nuk pranohet ... kur: a) raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave tregon që burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete ose ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve; b) raportet e Byrosë Kombëtare të Hetimit ose Shërbimit Informativ Shtetëror tregojnë se kandidati ka lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"; c) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit. 5. ..., Këshillat vendosin pranueshmërinë e kandidatëve, bazuar në informacionin që kanë marrë për rezultatet e verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre. ...”.

18. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten {...}, u kërkua raportim nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI), i cili ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin nr. 187/23 prot., datë 25.10.2024.

18.1 Sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, kandidatja {...} ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

18.2 Po ashtu, sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit janë kryer kontrole të plota për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara nga kandidatja {...}, për periudhën pas dhënies së vendimit nga ana e organeve të rivlerësimit, duke konkluduar se për kandidaten:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

19. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten {...} u kërkua informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

19.1 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informacioni u dërgua me Shkresën nr. 13138/1 prot., datë 26.06.2024, protokolluar në Këshill me aktin nr. 3235/8 prot., datë 28.06.2024 ku për kandidaten {...} nuk rezulton të jetë i regjistruar për ushtrimin e ndonjë aktiviteti me karakter pasuror.

19.2 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me Shkresën nr. 13862/1 prot., datë 10.07.2024, protokolluar në Këshill me aktin nr. 3235/9 prot., datë 11.07.2024, ku për kandidaten {...} dhe personin e lidhur me të, nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

20. Në kushtet kur nga informacionet respektive të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nuk jepej ndonjë e dhënë me karakter pasuror për kandidates, u vlerësua se nuk kishte vend për t'iu kërkuar ILDKPKI-së bërja e një kontrolli shtesë.

21. Po ashtu, referuar të dhënave të përshkruara në Raportin e ILDKPKI-së, të nxjerra nga dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidatja, si dhe ai i administruar nga korrespondenca me subjekte shtetërorë dhe privatë, dokumentacion që evidentohet hollësisht në Raport, sikundër dhe

analizës financiare të bërë nga ky organ publik, përgjegjës për kontrollin e deklarimit të pasurive dhe konfliktit të interesave sipas Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”, i ndryshuar, nuk u konstatua mangësi në raportim, shkak për të cilin u vlerësua se nuk kishte vend për raportim shtesë nga ky organ.

22. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kandidaten {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga kandidimi sa i përket kriterit të pasurisë. Konkretisht verifikohet që:

- a) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë;
- b) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) kandidatja ka burime financiare për të justifikuar pasuritë e saj;
- ç) deklarimi nga kandidatja i pasurisë, asetëve ose të interesave private, të detyrueshme për t’u deklaruar, është i plotë, i vërtetë dhe i saktë

## **B. Për kriterin e figurës**

23. Për kandidaten {...} u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikat 7 dhe 8, të nenit 48 në lidhje me pikat 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusit, për periudhën pas dhënies së vendimit nga organet e rivlerësimit.

23.1. Nga raportimet e institucioneve ligjzbatuese nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidates {...} i me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e saj në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme.

24. Nga raportimi i Byrosë Kombëtare të Hetimit, sipas shkresës nr. 63 prot., datë 25.06.2024 protokolluar në Këshill me aktin nr. 20 prot., datë 26.06.2024, nuk rezultoi ndonjë informacion i vlefshëm për qëllimet e verifikimit për kandidaten znj. {...}.

25. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten {...}, në kushtet kur kjo kandidatë ka qenë magjistrat në detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga ky ligj, kandidatja i është nënshtruar verifikimit sipas këtij ligji. Për rrjedhojë, informacioni iu kërkua Strukturës së Posaçme për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.



26. Nga Struktura e Posaçme pranë Këshillit informacioni u dërgua me Shkresën nr. 3231/1 prot., datë 13.06.2024, ku për kandidaten {...} është bërë me dije se: - ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit më datë 22.04.2016; -formulari është regjistruar me numrin unik 000148- formulari i vetëdeklarimit është bërë publik, në faqen zyrtare të web; - nuk ka të dhëna, të deklaruar që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji; - nga Sektori i gjendjes civile, nuk ka rezultuar ndryshime të dhënave të gjendjes civile -nga Sektori i gjendjes gjyqësore personi rezulton (e padënuar); - deri më sot nuk ka pasur indicie apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme.

27. Kandidatja znj. {...} iu nënshtrua verifikimit të integritetit sipas Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, në kushtet kur ajo është e datëlindjes 13.07.1975, sikurse përcaktohet në pikën 8, Seksioni B, Kreu IX, të vendimit 75/2019, pra më e hershme se korrik 1977.

27.1 Mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit ka kryer verifikimin përkatës, duke përcjell në Këshill, me Shkresën nr. 486/6 prot., datë 23.09.2020<sup>2</sup>, Vendimin nr.446, datë 15.09.2020, me të cilin është vendosur:

*“1. Të informojë Institucionin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, për informacionin që kërkohet me shkresën nr. 2339/1 prot., datë 17.08.2020, “Kërkesë”, për verifikimin e pastërtisë së figurës, përpara emërimit të 7 (shtatë) kandidatëve për Gjyqtarë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, se: a) Për zonjat dhe zotërnjtë ... 5. {...}{...}{...}, ..., nga verifikimet e kryera deri tani, bazuar në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenit 28, gërma “ë” dhe 49 të tij, si dhe përcaktimeve të nenit 29 të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, rezulton se:*

- 1. Nuk kanë qenë persona në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm;*
- 2. Nuk kanë qenë bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit;*
- 3. Nuk kanë qenë anëtar të ish-Sigurimit të Shtetit deri në 2 korrik 1991, sipas përcaktimeve të Nenit 29, pika 2 Ligjit nr. 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar....”.*

28. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidaten {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga kandidimi sa i përket kriterit të figurës. Konkretisht verifikohet që:

- a) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015;
- b) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit të Statusit, të kryejë

---

<sup>2</sup> Informacion i marrë nga verifikimi i bërë më herët në vendim nr. 602 datë 04.12.2020 te KLGJ-së.

verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e saj;

- c) për kandidaten nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- ç) për kandidaten nuk ka të dhëna që të ketë qenë anëtare, bashkëpunëtoresh ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit, përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar;
- d) për kandidaten nuk ka të dhëna që të ketë qenë ose të jetë bashkëpunëtoresh, informatore ose agjente e shërbimeve të inteligjencës;
- dh) për kandidaten nuk ka ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me figurën dhe integritetin e saj, mbi të cilat mund të gjykohej për pranueshmërinë ose jo të saj për komandimin si gjyqtare në ILD.

**29. Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri “në kohën e kandidimit, të mos jetë kryetar i një gjykate ose anëtar i organeve drejtuese të grupeve të interesit, të tilla si shoqata ose sindikata magjistratësh etj.”**

29.1 Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit gjatë verifikimit kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për Inspektor në ILD, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 284 datë 29.05.2024, rezultoi se në kohën e kandidimit, nuk ushtronte funksionin e kryetarit në gjykatë ose anëtar i organeve drejtuese të grupeve të interesit, të tilla si shoqata ose sindikata magjistratësh etj. duke plotësuar kështu kriterin e shkronjës “b”, të pikës 8, të Vendimit të Këshillit nr.284 datë 29.05.2024.

**30. Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i “të jetë vlerësuar të paktën “shumë mirë” në dy vlerësimet e fundit të performancës etike dhe profesionale”.**

30.1 Të jetë vlerësuar të paktën “shumë mirë” në dy vlerësimet e fundit të performancës etike dhe profesionale si kriter për ngritjen në detyrë edhe në Gjykatën e Lartë, që gjen reflektim në nenin 55, pika 4 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin” si dhe shkronjën “c”, të pikës 8, të Vendimit të Këshillit nr.284 datë 29.05.2024.

Për kandidaten znj. {...} u administruan dokumentacioni përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit i dy vlerësimeve etike dhe profesionale të miratuara me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 264 dhe nr. 265, datë 28.06.2021.

- Sipas Vendimit të Këshillit nr. 264, datë 28.06.2021, kandidati është vlerësuar/graduuar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mire”;

- Sipas Vendimit të Këshillit nr.265, datë 28.06.2021, kandidati është vlerësuar për vitin 2019, në nivelin “Shkëlqyeshëm”, duke plotësuar kështu kriterin e “të jetë vlerësuar të paktën “shumë mirë” në dy vlerësimet e fundit të performancës etike dhe profesionale”.

### **31. Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.**

31.1 “Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter për ngritjen në detyrë edhe në Gjykatën e Lartë, që gjen reflektim në shkronjën “ç”, të pikës 8, të Vendimit të Këshillit nr. 284 datë 29.05.2024, është parashikuar në nenin 48, pika 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “*Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë*”.

31.2 Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 10.06.2024, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “*Nuk kam masë disiplinore në fuqi*”.

31.3 Sipas informacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

31.4 Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet që kandidatja znj. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi, duke plotësuar kështu kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

## **IV. KONKLUZIONE**

32. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidaten znj. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

33. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidaten znj. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja i përmbush ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e saj nga kandidimi. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidates dhe vijimin e procedurës së mëtejshme të komandimit “Inspektor” në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr.284 datë 29.05.2024.

## **PËR KËTO ARSYE**

Mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikat 7 dhe 8, të nenit 48 dhe 55, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e

gjqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “dh”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, të Vendimit e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” i ndryshuar, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatori, z. Klodian Kurushi,

### **VENDOSI:**

1. Kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurave të komandimit “Inspektor” në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

### **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**